

**SHPLLJE TE HAPJES SE PROGRAMEVE TE PRAKTIKAVE PROFESIONALE GRADUATE  
INTERNSHIPS****MESONI ME SHUME RRETH NESH SI NJE PUNEDHENES I MUNDSTEM NDERKOHE QE NE MESOJME ME  
SHUME RRETH JUSH****❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISË**

Gener 2 përfaqëson një nga kompanitë më me emër në sektorin e ndërtimeve e të zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Kompania zotëron një gamë të zgjeruar aktivitetesh të shtrira në industri të tilla si ndërtim, infrastrukturë e menaxhim projektesh inxhinierike, energji e telekomunikacion, menaxhim pronash e pasurish të paluajtshme, aktivitete komerciale, ISP dhe media. Në rrugëtimin afro 30 vjecar, kompania Gener 2 ka prezantuar risi që kanë lënë gjurmë në tregun shqiptar e atë rajonal, duke zhvilluar projekte strategjike, duke zbatuar standarde të larta cilësore të bazuara në eksperiencat më të mira bashkëkohore ndërkombëtare, duke kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

**Në kuadër të zhvillimit të politikave rinore te punesimit, kompania Gener 2, shpall hapjen e thirrjes për aplikim në Programet e Praktikave profesionale pranë kompanise dhe projekteve specifike të saj.**

**❖ TITULLI****Praktike Profesionale****❖ KRITERET KRYESORE**

Janë të inkurajuar të aplikojnë në këtë program:

- Studentë të degëve/ profileve: Inxhinieri Ndërtimi, Inxhinieri Mekanike, Inxhinieri Elektrike.
- Studentë të cilët janë duke kryer studimet në nivelin Master, cikli i parë dhe i dytë;
- Të sapodiplomuar (prej 1 një viti);
- Studentë, mesatarja e të cilëve është 7.5;
- Kohëzgjatja e praktikës mesimore është deri 6 (gjashtë ) muaj;
- Dokumentacioni i kërkuar:
  - Curriculum Vitae;
  - Diplomë e shkollës së lartë në rastin kur kandidati ka përfunduar studimet e larta;
  - Lista e notave :
- Në rast se kandidati vazhdon studimet e larta, lista e notave të semestrave të përfunduar deri në momentin e aplikimit, e lëshuar nga Universiteti ku kandidati po kryen studimet e larta.
- Plotesimi i Formularit të Aplikimit për Praktikë Profesionale të cilin do ta gjeni të publikuar në faqen zyrtare [www.gener2.al](http://www.gener2.al) në seksionin “Aplikoni për praktikat profesionale”

Të gjithë të interesuarit, janë të lutur që të dërgojnë dokumentat e mësipërme nëpërmjet adresës së e-mailit [careers@gener2.al](mailto:careers@gener2.al)

Afati i fundit i aplikimit është **data 10 Shkurt 2023, ora 17:00.**

\* Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen.

\* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi “Mbrojtjen e të dhënave personale”